



Fshati Prush, Komuna Vaqarr, Tirane-Albania
Mob:+355(0)682084945
Tel:+355(044)803370
E: info@helphelife.org.al
W: www.helphelife.org

Termet e Referencës

Manaxher projekti

Organizata:	Shoqata Ndhmoni Jetën Fshati Prush, Njesia Administrative Vaqarr, Tirane Tel: +355(044)803370 <i>Web site: www.helphelife.org; E-mail: info@helphelife.org.al</i>
Projekti:	“Mbështetja në moshë të hershme, një mundësi për zhvillimin e fëmijës”
Koha e angazhimit	10/12/2021 – 11/05/2022
Donor	Bashkia Lezhë në kuadër të Programit Rajonal për Demokracinë vendore në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD)
Afati i aplikimit	6 Dhjetor 2021

Prezantimi

Shoqata “Ndhmoni Jetën” është organizatë Kombëtare jo-fitimprurëse, e ngritur në Tiranë në Shtator 1998, si një iniciativë e një grupi prindërisht të fëmijëve me aftësi të kufizuara me qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe gjithëpërfshirjen e personave me AK në shoqëri.

Shoqata ka një eksperiencë dhe ekspertizë të ngritur që prej operimit të saj në fushën e trajtimit psiko-socio-educativ të fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara, duke ofruar Modele të trajnimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara me një ekip multidisiplinar. Referuar kësaj ekspertize, Shoqata ka fokusuar punën e saj në rritjen e kapaciteteve të specialistëve që punojnë me fëmijët me aftësi të kufizuara në institucionet e edukimit parashkollor (çerdhe/kopështe), shkollë, shërbime rehabilituese në qendër komunitare/qendra ditore, mbështetje në familje, ngritjen e vetdijes dhe informacionit të prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe anëtarëve të tjerë të familjes dhe komunitetit, si dhe advokaci dhe lobimin për respektimin e të drejtave të këtij target grupi në zbatim të Konventës për të Drejtat e Personave me AK.

Shoqata, me mbështetjen e ‘Bashkia Lezhë në kuadër të Programit Rajonal për Demokracinë vendore në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD), ka filluar implementimin e Projektit “*Mbështetja në moshë të hershme, një mundësi për zhvillimin e fëmijës*”, i cili implementohet në qytetin e Lezhës.

Projekti është dizenuar tju vij në ndihmë fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe ata me vështirësi në zhvillim që ndjekin Institucionet e edukimit të hershëm në qytetin e Lezhës. Kjo gjë do të arrihet duke trajnuar edukatorët e institucioneve të edukimit të hershëm, si dhe stafit mbështetës që punon për zhvillimin e fëmijëve me vështirësi në zhvillim në këto institucione dhe prindërit e tyre. Gjithashtu, projekti do të ngrej Rrjetin lokal të Institucioneve publike dhe private që punojnë me/për fëmijët me aftësi të kufizuara, në bashkëpunim të ngushtë me Bashkinë Lezhë duke u fokusuar në ngritjen e kapaciteteve të tyre në drejtim të fëmijëve me AK.

Objektivat kryesore dhe rezultatet e projektit janë:

Objektivi i Përgjithshëm:

Të përmiresojmë kapacitetet e fëmijëve me vështirësi në zhvillim në drejtim të zhvillimit mendor, social dhe edukativ, dhe të ndihmojmë ata të kenë një jetë të pavarur dhe gjithëpërfshirëse në komunitet.

Objektivat Specifikë:

OS.1. Të rris kapacitetet e prindërve të fëmijëve me vështirësi në zhvillim dhe punonjesve të edukimit të hershem të identifikojnë dhe mbështesin zhvillimin e fëmijëve me vështirësi në zhvillim, dhe rrisin aksesin në shërbime cilësore.

OS.2 Te rritet niveli i ndërgjegjësimit të institucioneve (shëndetësore, arsimore, punësimit, ofrues shërbimi, etj) në nivel lokal dhe anetare të tjera të komunitetit në bashkinë Lezhe për të adresuar më mirë nevojat e PAK.

Qëllimi i shërbimit:

Në kuadër të implementimit të këtij projekti, Shoqata Ndhmoni Jetën kërkon të kontrakttoj një ekspert, të aftë për të demonstruar aftësi teknike dhe humane për të kryer detyrën e Manaxherit të Projektit i cili implementohet në qarkun e Lezhës.

Përgjegjësitë e Manaxherit

Manaxheri do të angazhohet në kryerjen e detyrave të mëposhtme:

- Manaxhimin e aktiviteteve të projektit sipas Planit të aktiviteteve të prezantuara në Projekt propozim,
- menaxhon të gjithë stafin e Projektit,
- ndjek performancën e tyre, etikën e punës,
- bashkërendon proceset e planifikimit javor dhe zbatimin e tyre në kohë dhe me cilësi.
- merrë një rol aktiv në zbatimin e aktiviteteve, ndërlihdje ndërsektoriale me institucionet që do të jenë pjesë e zbatimit të projektit.
- Koordinon aktivitetet e projektit me aktoret përgjegjës.
- Mban kontakte të vazhdueshme me donatorin mbi ecurinë e projektit.
- Përgatit dokumentacionin e nevojshëm për perzgjedhjen e eksperteve, kontratat e tyre dhe deri në finalizimin e shërbimit në përputhje me objektivat dhe aktivitetet e projektit.
- Përgatit dokumentacione të raporteve periodike mbi ecurinë e Projektit.
- Përcjell dokumentacion financiar për Bashkinë Lezhe, si donatori i këtij projekti.

Përgjegjësitë e Ndhmoni Jetën

- Të siguroj një ambient pune komod dhe me kushte optimale,
- Të siguroj transportin e manaxherit në vendin ku do të kryhen aktivitetet e projektit.
- Të kryej pagesat e pagesat sipas legjislacionit në fuqi.

Vendi i kryerjes së shërbimit: Tirane dhe Lezhë

Kohëzgjatja e angazhimit: 10 Dhjetor 2021 – 11 Maj 2022

Politikat e mbrojtjes së fëmijëve të Ndhmoni Jetën:

Personat që do të punojnë me Kontrata Shërbimi për Ndhmoni Jetën duhet të pranojnë me shkrim se ata kanë kuptuar “Politikën e Ndhmoni Jetën për Mbrojtjen e Fëmijëve” dhe standartet që përcakton kjo politike.

Kualifikimi ose eksperiencia që kërkohet

Specialisti duhet të përmbushi kërkesat si më poshtë:

- Të zotëroj një diplomë universiteti në fushën e Manaxhim, Pune sociale, Psikologji.
- Të ketë minimum 5 vite eksperiencë profesionale në fushën e manaxhimit të projekteve në sektorin e shoqërisë civile apo projekte që kanë në fokus fëmijët me aftësi të kufizuara;
- Njohuri mbi situatën e të drejtave të fëmijëve me AK në Shqipëri si dhe legjislacionin shqiptar;
- Aftësi shumë të mira në komunikim dhe shkrim raportesh;
- Aftësi për të punuar me pak supervizion dhe nën presion.

Kandidatët e interesuar të cilët i plotësojnë kriteret e parashtruara në këto Terma Reference, mund të dorëzojnë dokumentat e mëposhtëm brenda dt.6 Dhjetor 2021:

- Letër motivimi që shpjegon motivimin tuaj për të aplikuar për këtë pozicion dhe se si ju i plotësoni kriteret.
- CV e detajuar
- Letër reference
- Diploma

Vetëm kandidatët e përzgjedhur për fazën e intervistës do të njoftohen.

Aplikimet tuaja mund ti dërgoni në këtë adresë e-maili: info@helphelife.org.al ose në adresën postare: Shoqata Ndiemoni Jetën, Fshati Prush, Njësia Administrative Vaqarr, Tiranë.

Përzgjedhja e ekspertit do të bëhet bazuar në atë:

- Se sa mirë do të plotësoj kërkesat e parashtruara në Termat e referencës.
- Eksperiencat e ngjashme.

Gjatë procesit të vlerësimit do të kenë prioritet aplikuesit nga Bashkia Lezhë